



Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit

Programi i studimit: Udhëheqja në Arsim

Niveli i studimeve:
Master

Numri i kredive:
90 ECTS

Akredituar për periudhën:
1 Tetor 2016- 30 Shtator 2019

]

Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financuar nga Bashkimi Europian.

The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.

PËRMBAJTJA:

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	3
2. REZULTATET E PRITURA	4
3. PROGRAMI STUDIMOR: Udhëheqja në arsim	5
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS	6

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi Udhëheqja në arsim ka për qëllim të ofrojë një aftësim profesional dhe shkencor për të gjithë të interesuarit për karrierë menaxhimi në institucionet e arsimit parauniversitar. Programi synon t'u ofrojë pjesëmarrësve mundësi për t'u avancuar në nivel të përballjes me sfidat e sistemit shkollor në Kosovë. Ky program është hartuar mbi bazën e kësaj kornize, duke marrë parasysh këto elemente:

- Trendet bashkëkohore të zhvillimit dhe përmirësimit të shkollës si organizatë nga pikëpamja e rolit të administratës dhe udhëheqjes në këtë proces.
- Strukturën dhe organizimin e tanishëm të përgatitjes së mësimit në Universitetin e Prishtinës.
- Zhvillimet e fundit në aftësimin e mësimit, administratorëve dhe udhëheqësve në nivel master në Evropë.
- Cilësinë e përgatitjes së mësimit dhe drejtorëve në shkollat e Kosovës në të kaluarën dhe tani.
- Kontekstin dhe sfidat e drejtorëve në shkollat e Kosovës.
- Kontekstin dhe sfidat e sistemit të arsimit në përgjithësi në Kosovë, si dhe kërkesat në nivel sistemi për kualifikimin shtesë të administratorëve dhe udhëheqësve në institucionet e arsimit parauniversitar dhe nevojat për shkathhtësi shtesë për zyrtarët e administratës së arsimit parauniversitar.

2. REZULTATET E PRITURA

Me përfundimin e këtij programi studentët do të duhet:

- Të zhvillojnë aftësitë për të kuptuarit e avancuar të përmbajtjeve dhe të aftësohen për zbatimin në praktikë të ecurive moderne për qeverisje dhe menaxhim.
- Të zhvillojnë aftësi për të implementuar politika për qeverisje dhe udhëheqje të institucioneve arsimore, si dhe programojnë veprimtaritë për mësimdhënie të avancuar.
- Të aftësohen në proceset e planifikimit të veprimtarisë së shkollës, planifikimin afatgjatë, afatmesëm dhe planifikimin operativ (vjetor), të planit të bashkëpunimit me organet e shkollës (Këshilli i shkollës, Këshilli i prindërve, Këshilli i nxënësve, Këshillat profesionale) si dhe bashkëpunimin me komunitetin.
- Të zhvillojnë shkathtësitë për konsultimin, analizën dhe implementimin e kërkesave, të cilat burojnë nga legjislacioni arsimor.
- Të zhvillojnë aftësi për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për mësimdhënie dhe të nxënë të avancuar dhe të mbështetur në dokumente valide, standarde dhe kurrikulën zyrtare.
- Të zhvillojnë sistematikisht shkathtësitë për udhëheqje të institucionit dhe për menaxhimin e aktiviteve ditore, çështjeve specifike të mësimdhënies, të komunikimit dhe të politikave, që burojnë nga dokumentet e të drejtave universale si gjithëpërfshirja, barazia gjinore, etj.
- Të demonstrojnë shkathtësi për përcaktimin e prioriteteve sipas rëndësisë dhe sipas urgjencës.
- Të demonstrojnë të kuptuarit e zbatimit të stileve të ndryshme të udhëheqjes në kontekst të menaxhimit të shkollës.
- Të demonstrojnë shkathtësi për të hulumtuar problemet e zhvillimit të shkollës si organizatë, dhe sistemit të arsimit në përgjithësi.
- Të demonstrojnë aftësi për të kuptuar funksionim e shkollës në kontekst të sistemit të arsimit në Kosovë dhe politikave të tjera arsimore në vend.
- Të demonstrojnë aftësi për komunikim të efektshëm me të gjitha palët e interesit për implementimin e Kornizës së Kurrikulit të Kosovës dhe dokumenteve tjera kurrikulare në praktikë
- Të analizojnë procesin e zbatimit të kurrikulave në praktikë, si dhe përcjellin e analizojnë rezultatet në të nxënë sipas periudhave të vlerësimit.
- Të përcjellin punën e gjithëmbarshme të mësimdhënësve, sipas fushave të arritjes së kompetencave mbi bazën e rezultateve të dala nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm.

3. PROGRAMI STUDIMOR: Udhëheqja në arsim

VITI I PARË

SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Udhëheqja në arsim	O	3	7
2.	Planifikimi zhvillimor i shkollës	O	3	5
3.	Ndryshimet në arsim	O	3	7
4.	Hyrje në hulumtimet arsimore	O	3	6
5.	Teoria dhe procesi i zhvillimit të kurrikulës	Z	3	5
6.	Komunikimi në arsim	Z	3	5
7.	Statistika sociale	Z	3	5
8.	Arsimi ndërkombëtar	Z	3	5
Gjithsej			18	30

SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Metodat e hulumtimeve në arsim	O	3	7
2.	Teknologjitë e edukimit dhe mësimi elektronik	O	3	6
3.	Administrimi i shkollës	O	3	6
4.	Politikat arsimore	O	3	6
5.	Hulumtimi në veprim	Z	3	5
6.	Standardet dhe vlerësimi në arsim	Z	3	5
7.	Zhvillimi i organizatës	Z	3	5
8.	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Z	3	5
Gjithsej			18	30

VITI I DYTË

SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	Orë	ECTS
1.	Tema e masterit	O		30
Gjithsej				30

4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p>Udhëheqja në arsim</p> <p>Në këtë kurs do të shqyrtohen teoritë dhe praktikat moderne të udhëheqjes në arsim. Temat që do të mbulohen në këtë kurs janë: motivimi, stilet e udhëheqjes, aftësitë, sjellja dhe kompetencat e udhëheqësve në arsim, ndërtimi i vizionit të përbashkët, etj. Çështjet tjera që trajton ky kurs, kanë të bëjnë me ndihmën dhe mbështetjen e udhëheqësit për krijimin e kushteve dhe mjedisit të përshtatshëm për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, si dhe zhvillimit organizativ.</p>
2	<p>Planifikimi zhvillimor i shkollës</p> <p>Me anë të këtij kursi synohet që studentët të njihen me metoda bashkëkohore të planifikimit dhe t'i shfrytëzojnë ato në punën e tyre. Meqë planifikimi bashkëkohor realizohet në bashkëpunim me njerëzit e tjerë, puna e studentëve gjatë këtij kursi organizohet në grupe, ashtu që krahas njohurive për planifikim të fitohen edhe shprehi të komunikimit dhe të bashkëpunimit me të tjerët. Metodën, që prezantohen gjatë realizimit të këtij kursi, mund të shfrytëzohen në mjedise arsimore, por edhe në mjedise të tjera me karakter jobiznesor.</p>
3	<p>Ndryshimet në arsim</p> <p>Ky kurs trajton aspektet e ndryshimit në arsim e në veçanti ndryshimeve organizative dhe individuale. Temat kyçe janë: të kuptuarit e sistemeve të ndryshme arsimore, të kuptuarit e ndryshimit arsimor, rezistenca ndaj ndryshimit dhe përballja me të, shqyrtimi i perspektivave të ndryshme të ndryshimeve në arsim, menaxhimi i ndryshimit, etj. Kursi trajton edhe aspektet e ndryshimeve në arsim në nivel shkolle, rajoni dhe ndryshimet në nivel të sistemit, si dhe shqyrtohet roli i udhëheqësit në krijimin e organizatës të orientuar në ndryshime.</p>
4	<p>Hyrje në hulumtimet arsimore</p> <p>Kursi është Hyrje në fushën e hulumtimeve arsimore, me theks të veçantë në leximin e hulumtimeve dhe të kuptuarit e procesit të hulumtimit shkencor. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i hulumtimeve në arsim, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve, formulimi i propozimeve për hulumtim, përkufizimi i problemeve, formulimi i temave, formulimi i hipotezave, përcaktimi i mostrës, rishikimi i literaturës, instrumentet për mbledhjen e të dhënave, analiza dhe interpretimi i të dhënave, raportimi i hulumtimeve arsimore, etj. Studentët do t'iu ekspozohen këtyre çështjeve nga këndvështrimi kritik dhe analitik i përgjithshëm, në mënyrë që të njihen me këto koncepte bazë, të cilat do të studiohen dhe zbatohen më në hollësi më vonë gjatë programit.</p>
5	<p>Teoria dhe procesi i zhvillimit të kurrikulës</p>

Kursi trajton aspektet e zhvillimit historik të kurrikulës, zhvillimet që ndikojnë në formësimin e kurrikulës, si ndikimin e kurrikulës në vlerat shoqërore, ekonomike dhe politike. Çështjet tjera që adreson ky kurs janë: orientimet dhe parimet bazë në hartimin, zbatimin, dhe vlerësimin e kurrikulës, si dhe roli i administratorit dhe udhëheqësit në zbatimin e kurrikulës në shkollë.

6 Komunikimi në arsim

Kursi *Komunikimi në arsim* ofrohet për të promovuar procesin e komunikimit në arsim, njohjes dhe zbatimit të suksesshëm në praktikën mësimore. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të komunikimit, të modaliteteve, teknikave dhe teknologjisë bashkëkohore për komunikim në veprimtarinë arsimore, me qëllim të avancimit të shkathtësive themelore intelektuale në mësim, si të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit aktiv, me qëllim të zbatimit të suksesshëm të tyre në praktikë. Në kurs ofrohen përmbajtje për modalitetet dhe kërkesat aktuale për komunikim ndërveprues në mësim, duke iu referuar komunikimit autokasional, koaksional dhe formave të ndryshme të komunikimit në grup për qëllime mësimore. Kursi ofron modalitete të ndryshme të teknologjisë së fjalës së shkruar dhe të fjalës së folur në praktikën arsimore. Veçmas, do të trajtohet aktualiteti dhe zbatimi i modaliteteve të fjalës së folur dhe të fjalës së shkruar, si dhe të modaliteteve të teknologjisë arsimore për komunikim në distancë.

7 Statistika sociale

Kursi *Statistika sociale* mbarështron teknikat statistikore, që përdoren më së shpeshti në kontekstet sociale dhe të edukimit. Pjesa e parë trajton hyrjen në prezantimet tabelare dhe grafike të të dhënave, duke i përcjellë me statistikën bazike deskriptive (përshkruese). Për më tepër, pjesa e dytë e kursit, trajton metodat më të përbashkëta për statistikën konkluduese. Tema të tjera, që do të adresohen në pjesën e tretë të ligjëratës në kuadër të këtij kursi, trajtojnë një hyrje më të detajzuar të metodave më të avancuara për analizën e të dhënave ndërmjet variablave. Po ashtu, në kuadër të këtij kursi, studentët do të njihen me modelin e prezantimit dhe trajtimit të paketës statistikore për shkencat sociale, ku do të kenë mundësi, në rrafshin praktik, të aplikojnë njohuritë e marra nga kjo lëndë dhe t'i zbatojnë gjerësisht në hulumtimet në fushën e edukimit.

8 Arsimi ndërkombëtar

Ky kurs shërben si hyrje në të kuptuarit e zhvillimeve kryesore në arsimin ndërkombëtar. Kursi do të ekspozojë studentët ndaj sistemeve të mira të arsimit nëpër botë dhe shembujve të kontinenteve të ndryshme, me fokus të qartë në lidhjet mes kulturës dhe arsimit (përfshirë mostra të modeleve të edukimit si aziatike, skandinave, të Evropës Perëndimore dhe anglo-saksone). Kursi do t'i ekspozojë studentët ndaj tendencave më të rëndësishme në fushën e arsimit ndërkombëtar. Rezultatet e vlerësimeve ndërkombëtare të tilla si PISA, TIMMS, PIRLS do të përpunohen dhe implikimet, që këto kanë në zhvillimin e arsimit. Përveç kësaj, moduli do të shqyrtojë

	tendenat dhe analizat e aktorëve të mëdhenj të arsimit si UNESCO, Banka Botërore dhe OECD dhe aktivitetet e ndryshme të tyre.
9	<p>Metodat e hulumtimeve në arsim</p> <p>Kursi shqyrton aspektet e përgjithshme teorike dhe metodologjike të të kuptuarit dhe realizimit të një projekti hulumtues në fushën e arsimit. Kursi në njërën anë adreson qasjet dhe orientimet, që duhet të zgjedhë hulumtuesi (ontologjia dhe epistemologjia) dhe në anën tjetër adreson aspektet teorike dhe praktike si: definimi dhe formulimi i problemeve hulumtuese; formulimi i pyetjeve hulumtuese dhe hipotezave; hartimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave; analiza dhe interpretimi i të dhënave (duke përfshirë përdorimin e programeve të ndryshme softuerike për analizën e të dhënave); raportimi i hulumtimeve. Kursi adreson edhe aspekte të ndryshme të hulumtimeve kualitative dhe kuantitative dhe shtjellon modele të ndryshme të hulumtimeve si: studime rasti, hulumtime përshkruese, hulumtime etnografike, hulumtime vepruese, hulumtime vlerësuese, etj. Në veçanti kursi adreson modalitetet e analizës së të dhënave sasiore, përmes përdorimit të programit SPSS, si dhe analizën e të dhënave kualitative.</p>
10	<p>Teknologjitë e edukimit dhe mësimi elektronik</p> <p>Ky kurs ofron njohuri për mënyrat e integrit të teknologjive të edukimit në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit në përgjithësi, veçanërisht në fushën e udhëheqjes së institucioneve arsimore. Gjithashtu, ofron njohuri edhe për mësimin elektronik dhe format dhe mënyrat e realizimit të tij. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: teknologjitë për mësimdhënie dhe të nxënë, teknologjitë e edukimit dhe të nxënit aktiv, teknologjitë e internetit në edukim, simulimet kompjuterike dhe animacionet në edukim, realizimi i eksperimenteve përmes kompjuterit, teknologjitë e të nxënit elektronik, teknologjitë e bashkëpunimit të mbështetura nga kompjuteri, menaxhimi përmes teknologjisë, format e menaxhimit elektronik, vlerësimi i teknologjive të edukimit për nga aspekti i ngritjes së performancës së mësimdhënies dhe të nxënit.</p>
11	<p>Administrimi i shkollës</p> <p>Kursi trajton proceset e administrimit në shkollë dhe ndërlidhjen e tyre me zhvillimin e shkollës dhe përmirësimin e performancës së organizatës. Temat që do të trajtohen në këtë kurs janë: menaxhimi i resurseve dhe mënyra e sigurimit të resurseve shtesë për përmirësimin e performancës së organizatës, menaxhimi i resurseve njerëzore, planifikimi financiar, monitorimi dhe kontrolli, menaxhimi i kohës, zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve, etj.</p>
12	<p>Politikat arsimore</p> <p>Kursi ka për qëllim të ndihmojë studentët të kuptojnë qartë konceptin e politikës arsimore, definimin dhe llojet e saj. Në veçanti, kursi do të shtjellojë kontekstin e politikave arsimore në Kosovë, duke synuar një analizë kritike të tyre në lidhje me teoritë e ndryshme të funksionimit të sistemit të arsimit. Moduli do të vërë në dukje,</p>

	<p>për studentët, ciklin e politikave, duke përfshirë një orientim praktik për hartimin e politikave, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Në këtë rast, do të shtjellohen dimensione praktike të perceptimit të politikave në nivel Kosove dhe realitetit praktik të zbatimit të tyre.</p>
13	<p>Hulumtimi në veprim</p> <p>Si një nga llojet e hulumtimeve në arsim, hulumtimi në veprim është një komponentë e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe edukatorëve dhe reflektim kritik i praktikës së tyre profesionale dhe vlerave arsimore. Qëllimi i këtij kursi është përgatitja e studentëve për të përmirësuar praktikën e tyre, nëpërmjet zhvillimit të projekteve hulumtuese në klasë dhe në institucionet arsimore, ku ata punojnë. Gjatë kursit do të shqyrtohen karakteristikat themelore të hulumtimeve në klasë dhe llojet e tyre, mënyrat e identifikimit të problemeve, hapat e realizimit të hulumtimit në veprim dhe raportimi i tij.</p>
14	<p>Standardet dhe vlerësimi në arsim</p> <p>Kursi shqyrton teorinë dhe praktikën e vlerësimit, që influencojnë reformën në shkollë. Ndër të tjera, shqyrtohen aspekte si: vlerësimi, shikuar nga këndi etik dhe psikologjik, ndërlidhja e vlerësimit me të nxënësit, llojet e vlerësimit, vlerësimi me qëllim mësimitnxënien, vlerësimi i vazhdueshëm në klasë, vlerësimi formësues dhe përmbledhës, zbatimi i vlerësimeve të standardizuara kombëtare dhe vlerësimet ndërkombëtare, vlerësimi i programeve, vlerësimi përmes portofolios, vlerësimi i punimeve të shkruara, etj. Kursi gjithashtu trajton edhe aspektet e ndryshme të standardeve në arsim në nivele dhe kontekste të ndryshme (në nivel vendi dhe në nivel ndërkombëtar), duke përfshirë edhe procesin e caktimit të standardeve në arsim.</p>
15	<p>Zhvillimi i organizatës</p> <p>Zhvillimi i organizatës është një kurs i formimit të personit, që do të punojë (punon) në pozicione udhëheqëse nga më të thjeshtat deri tek më të lartat, në fusha të ndryshme në arsim, prodhim, apo të shërbimeve të ndryshme, si në sektorin privat edhe në administratën publike. Ky kurs mëson studentin si të kuptojë zhvillimin e organizatës, përmes sjelljes së punonjësve vartës, apo bashkëpunëtorë, për ta parashikuar, shpjeguar, kontrolluar dhe drejtuar, me qëllim arritjen e efektivitetit maksimal, duke u bazuar në përdorimin e burimeve njerëzore në dispozicion të organizatës. Zhvillimi i organizatës realizohet nëpërmjet shpjegimit të faktorëve individualë të sjelljes si: vlerat, qëndrimet, personaliteti, perceptimi, kultura kombëtare, të mësuarit, si dhe të faktorëve tjerë të organizatës si: kultura organizative, përdorimi i pushtetit, koalicionet, komunikimi, organizimi i punës në grup, stilet udhëheqëse, projektimi i punës, etj.. Zhvillimi i mirëfilltë e organizativ ka për synim motivimin e të tjerëve dhe vetes, si udhëheqës i organizatës, për një produktivitet sa më të lartë dhe kënaqësi maksimale në punë.</p>
16	<p>Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve</p>

Kursi adreson aspekte të përgjithshme të mësimit tërëjetësor dhe me fokus të veçantë në të kuptuarit e rëndësisë dhe modaliteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Kursi adreson modele të ndryshme të zhvillimit profesional si: modeli me bazë në shkollë, modeli i trajnimit të trajnerëve, duke identifikuar përparësitë dhe mangësitë e secilit model. Në anën tjetër, kursi adreson aspektet e të mësuarit profesional të mësimdhënësve, duke elaboruar modalitetet e zhvillimit të mësimdhënësve si p.sh. mentorimi i mësimdhënësve, reflektimi, planifikimi kolegjal, etj. Për më shumë, kursi adreson dimensionet teorike dhe praktike të procesit, në të cilin angazhohen mësimdhënësit për të kuptuar punën e tyre dhe identifikuar format e tejkalimit të sfidave në baza të vazhdueshme.

17

Tema e masterit

Tema e masterit përmban 30 ECTS dhe paraqet pjesën përfundimtare të programit Master. Rregullorja e studimeve Master rregullon pikat e përgjithshme të procedurave dhe rregullave të realizimit të punimit përfundimtar – Tezës së masterit.

Për shkrimin e temës duhet të zbatohen këto kritere:

1. Tema duhet të ketë 15 000 – 20 000 fjalë, në fontin 12, *Times New Roman*, *double-spaced*.
2. Referencat dhe citimi duhet të bëhen sipas standardit të APA-s (American Psychological Association).
3. Tema duhet të demonstrojë aftësinë e studentit për të zbatuar metodat dhe teoritë e hulumtimit shkencor në fushën e shkencave të edukimit apo aftësimit të mësimdhënësve në profilin e caktuar.
4. Tema duhet të demonstrojë aftësitë e studentit për të reflektuar dhe bërë punë hulumtuese në fushën përkatëse, duke shfrytëzuar bazë teorike të problemit.
5. Tema duhet të demonstrojë njohuritë, shkathtësitë teorike dhe analitike të studentit, për të treguar familjarizimin e tij/saj me terminologjinë, aspektet dhe zhvillimet në fushën përkatëse.
6. Temën e punimit e zgjedh vetë studenti, në konsultim me personelin akademik të fakultetit, e cila më pas duhet të aprovohet nga Këshilli i Fakultetit përmes departamentit apo kolegjiut, varësisht si përcaktohet nga aktet që rregullojnë këtë fushë. Kur studentit regjistrohet për të shkruar temën, duhet t'i caktohet edhe afati i përfundimit të saj, ndërsa studentët inkurajohen të nisin diskutimet me personelin akademik për temën para semestrit të tretë.
7. Tema e zgjedhur duhet të jetë e ndërlidhur me programin e studimit si dhe relevante për fushat prioritare hulumtuese të fakultetit dhe për zhvillimin e

sistemit shkollor në vend.

8. Përmbajtja akademike dhe aftësitë shprehëse të studentit duhet të jenë në harmoni me rregullat e drejtshkrimit.
9. Temat e shkruara në gjuhën shqipe, duhet të kenë të shkruar përmbledhjen edhe në gjuhën angleze, e nëse tema shkruhet në gjuhën angleze përmbledhja duhet të jetë e shkruar edhe në gjuhën shqipe.
10. Tema duhet të vlerësohet nga komisioni vlerësues më së shumti për dy muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit nga kandidati. Pas vlerësimit, pason prezantimi me gojë i temës, ku fillimisht paraqitet vlerësimi nga komisioni vlerësues dhe pastaj prezantimi nga kandidati.

Hollësitë e mëtuqjeshme rreth temës së masterit, si dhe formati i punimit të temës do të specifikohen në Doracakun përkatës, ndërsa procedurat dhe kriteret shtesë përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve Master në Fakultetin e Edukimit dhe në rregulloret e tjera në fuqi në Universitetin e Prishtinës.